

Fejton: “Shpërbërja e Jugosllavisë” (14)

Shndërrimi i Milosheviqit

Milosheviqi kishte ardhur si një politikan i ri në Prishtinë dhe të nesërmen ishte larguar që atje si lideri absolut i të gjithë serbëve

Serbët ishin në kërkim të një lideri që do t'i zbatonte planet e tyre nacionale dhe mu në atë kohë, në prill të vitit 1987, politikan i ri Slobodan Milosheviqi erdhi në Kosovë të takohej me nja 300 delegatë të partisë. Shumica e këtyre delegatëve ishin shqiptarë dhe takimi ishte i mbyllur. Mirëpo, derisa Milosheviqi po takohej me delegatët, nja 10.000 serbë lokalë u shfaqën para ndërtesës me kërkesën për të hyrë brenda dhe për të biseduar me Milosheviqin. Policia kosovare, atëherë e përbërë edhe nga shqiptarët, reagoi duke i ndaluar të hynin në ndërtesë. Kur serbët nuk deshën të largoheshin, policia i ndaloj me dhunë. Slobodan Milosheviqi doli nga ndërtesa dhe iu drejtua turmës: “Niko ne sme da vas bije” (“Askush nuk ka të drejtë t’ju rrahë”). I tha këto fjalë me dorën të ngritur lart. Televizionet serbe e kapën këtë pamje i regjistruan këto fjalë. Atë Milosheviqi bujti në Prishtinë. Gjithë natën ai qëndroi duke biseduar me serbët lokalë. Brenda natës u shndërrua në njeriun më të dashur të serbëve. “Milosheviqi u transformua, u ndez nga Kosova”, thoshte në atë

kohë mentori i tij, Ivan Stamboliq. Milosheviqi nisi të konsiderohej si një gjysmëprofet. Hyri në një varg të këngëve me Shën Savën dhe Car Lazarin. Pas transformimit të tij, profeti i ri serb, Milosheviq, promovoi një sistem kulturor dhe një ideologji të re. Sipas kësaj ideologjie që nuk ishte kurrfarë risie në historinë serbe, serbët po luftonin për ta mbrojtur ortodoksizmin nga myslimanët e pabesë dhe “Perëndimi i ligë”. Milosheviqi gjithë kohën pohonte se Serbia ishte e kanosur nga të gjitha anët. Ndërruan edhe qëndrimet e përgjithshme. Nisën të ngriteshin përmendore për Drazha Mihajloviqin dhe Milan Nediqin, militarët kuislingë të Luftës së Dytë Botërore. Mirëpo, derisa bëheshin këto, Milosheviqi publikisht deklaronte se Serbia nuk kishte interes t'i zgjeronte kufijtë e saj në dëm të asnjërës republikë fqinje. Mirëpo, proceset e përkeqësimit doktrinal zakonisht rrjedhin shpejt. Menjëherë, Milosheviqi kërkoi abolimin e krahinave autonome. Milosheviqi, Qosiqi



Politikani pak i njohur komunist, vetëm pak çaste pasi është bërë kjo fotografi më 1987 është shndërruar në liderin absolut të të gjithë serbëve

dhe serbët e tjerë të shquar të kohës, “eskaluan” me idenë ku është një serb, aty është Serbi. Milosheviqi financonte qendrat stërvitore paramilitare siç ishte ajo e Tarës në Mal të Zi dhe i përgatiste serbët për luftën që shumë nga ta as nuk e donin. Veprimet e Milosheviqi nxitën eufori në të gjitha anët dhe si rëndom euforia është një gjendje, në të cilën arsyeja nuk është shumë e bindshme. Porcesi i ringjalljes serbe, siç e quanin ata vetë, nxiti edhe rezistencë të brendshme dhe të jashtme. Nga brenda rezistenca ishte në formë të kritikës liberale nga ana e intelektualëve

si Sonja Biserko, Vesna Peshiq, Zarana Papiq dhe me një kritikë tjetër më të butë nga sa i përket qendrimeve kyçe nga ana e politikanëve të opozitës si Zoran Gjingjiq dhe Vuk Drashković. Njëfarë rezistence bëhej edhe nga të rinjtë që refuzonin t'i përgjigjeshin ftesës për të shkuar në shërbim ushtarak. Një rezistencë e ka bërë edhe kisha ortodokse. Në vitin 1992, kur forcat serbe po përparonin në Bosnjë, patriarku Pavle e ka mbajtur meshën e paqes në Beograd dhe në atë meshë ka bërë thirrje që Milosheviqi të largohet nga pushteti. Disa ditë më vonë,

“Shpërbërja e Jugosllavisë” është raport i përpiluar nga projekti “Iniciativa e intelektualëve”, rreth të cilit janë mbledhur historianë të shumtë nga Ballkani dhe mbarë bota për të hulumtuar gjenezën e konfliktit në ish-Jugosllavi. Ky projekt ka punuar në disa grupe të ndara, të cilat kanë trajtuar aspekte të ndryshme dhe kanë përpiluar raporte të veçanta. Grupi që ka punuar raportin rreth “Shpërbërjes së Jugosllavisë” është udhëhequr nga Sabrina Ramet dhe Latinka Perović. Për shkak të hapësirës, “Koha Ditore” e boton si fejton një variant të shkurtuar të raportit.

patriarku ka udhëhequr një grup serbësh në protesta për ta kërkuar dorëheqjen e Milosheviqit.

(Në numrin e nesërm: Çka u bë me protestat e patriarkut? Cila ishte rezistenca e jashtme që i bëhej Milosheviqit? A pat edhe rezistencë nga Perëndimi?)

Fejton: “Sekretet e spiunazhit botëror” (14)

Drejtësi për spiunët

Gjykimi i bashkëshortëve Rosenberg konsiderohej “gjykim i shekullit”. E megjithatë, gjykimi zgjati më pak se një muaj. Cila ishte e vërteta e tij

Ethen Greenglass ishte studente që ëndërronte të bëhej këngëtare. Julius Rosenberg ishte inxhenier. Të dy ishin të rinj dhe jetonin në New York në vitet tridhjetë të shekullit XX.

Ishin hebrenj. Kishin shkëlqim në sy kur e shikonin njëri-tjetrin dhe së shpejti u lidh fort. Zonjusha Ethen u bë zonja Rosenberg.

Të trishtuar nga përndjekjet që

në vitet dyzet ua bënte Hitleri hebrenjve, çifti bashkëshortor Rosenberg vendosi të hynte në partinë komuniste. Juliusi punonte në armatën amerikane, ndërsa Ethel kujdesej për punët e shtëpisë.

Pas Luftës së Dytë Botërore shumë gjëra kishin ndryshuar. Pritej të zhvillohej lufta në Kore, BRSS-ja kishte bërë bombën atomike dhe amerikanët vërenin se dikush po i spiunonte në Moskë. FBI-ja po përpiqej t'i gjente fajtorët.

Kërko e kërko dhe më në fund disa dëshmi spiunazhi u gjetën në shtëpinë e David Greenglassit, vëlla i Ethelit.

Nën pyetjet e agentëve e të detektivëve iu shua shkëlqimi në sy, i humbi vullneti dhe në fund e tradhtoi të motrën: Ajo dhe burri i saj janë spiunë, tha ai.

Gjyqi për spiunazh ndaj Rosenbergëve u quajt “Gjyqi i shekullit”. Prokuroi e bindi jurinë: Etheli i kishte shtypur mesazhet e Juliusi i kishte dërguar ato nëpërmjet një rrjeti të caktuar drejt e në Moskë. Prokuroi ishte më i miri që e kishte Amerika, ndërsa shteti ua kishte ofruar Rosenbergëve një avokat praktikant, të cilit ende i nxirrte buza qumësht.

Për më pak se një muaj, juria mori vendim: fajtorë, ndërsa gjykatësi nuk ngurroi që të dy t'i



Juluis dhe Ethel Rosenberg - spiunë apo viktima

dënonte me vdekje.

Rosenbergët vazhdonin të thoshin se janë të pafajshëm deri në çastin e tyre të fundit. Më 19 qershor të vitit 1953, ata të dy u ekzekutuan njëri pas tjetrit në karrigje elektrike.

Dyzet vjet pas vdekjes së tyre rasti i tyre u rishqyrtua në një gjykatë amerikane. Rosenbergët të vdekur e të harruar u shpallën të pafajshëm.

Megjithatë, dy vjet më vonë, më 1995, kur u hapën dosjet sekrete të FBI-ë dhe të KGB-së u pa se Julius Rosenbergu mund të kishte qenë i lidhur me rusët goxha ngushtë.

Mirëpo, kurrë nuk u kuptua faji i Ethelit. Vëllai i saj, David Greenglass, ka thënë pas daljes nga burgu se kishte gënjyer, kur kishte thënë se ajo ka qenë spiune e rusëve.

Ç’është e vërteta ende sot e gjithë ditën nuk është marrë vesh nëse Rosenbergët kanë qenë vërtet spiunë, apo kanë qenë viktima të një gjyqi të ndikuar në Amerikën demokratike.

(Fund)

(Në fejtonin e ardhshëm: “Rrëfimi për Al Kaponen: zërat e nëntokës”)

